

**PERMBLEDHJE JOTEKNIKE
NË OBJEKTIN E SHFRYTEZIMIT TE
MINERALIT TE KROMIT, NE ZONEN
MINERARE NR.277/6, OBJEKTI “QAFE
BUALL”, BASHKIA KLOS, QARKU
DIBER.**

PER SHOQERINE “MARA 2011” SH.P.K



PËRGATITËN RAPORTIN

STUDIO “OSKEOLA” SH.P.K



Te dhëna te përgjithshme dhe historiku minierës

I.- 1 Objekti per te cilin kërkohet te pajiset me leje minerare dhe mjedisore

Studimi gjeologo minerar dhe projekti tekniko ekonomik i shfrytëzimit te minerali te kromit, në objektin “Qafe Buall”, Klos, që ben pjesë në bashkine Klos, Diber, është kryer me porosi të shoqerise private “ Mara 2011” shpk, regjistruar ne QKB Tirane, me administrator zotin Bruno Mara me seli Lagjia "Pjeter Budi", Pallati pranë bashkise Burrel, qarku Diber.

Nëpërmjet tij synohet të shfrytëzohen gure gelqeror, sipas ligjit Nr.10304, date 15/07/2010 “Per Sektorin Minerar ne Republikën e Shqiperise” dhe akteve nenligjore te dala ne zberthim dhe per zbatim te tij, klasifikohen ne grupin e mineraleve grupit I-II-III(metalore).

Shrytëzimi do të bëhet me kariere nga shoqeria“Mara 2011i”sh.p.k”. Zona e kerkuar ka nje siperfaqe prej 0.984 km² dhe perfshihet midis kuotave +810m deri ne +840m.

I.-2 Vendndodhja e objektit

Me hollësisht pozicioni gjeografik që ka ky objekt në lidhje me objektet e tjera të zonës jepet ne planimetrine e vendosjes se këtij objekti në hartën topografike me nomenklature K – 34 – 89 – C – b (Bulqiza), në shkalle 1:25 000, grafiku nr. ...

Zona për të cilën kërkohet të merret leje minerare shfrytëzimi dhe ku do të punohet ka një siperfaqe të përgjithshme prej rreth 0.984 km² dhe ka keto kordinata:

PIKAT	Y	X
1	44 33 189	45 93 633
2	44 33 112	45 93 279
3	44 31 955	45 92 990
4	44 31 870	45 93827
5	44 33 008	45 94 064
6	44 32 986	45 93 897

Siperfaqja e zones se kerkuar per shfrytezim eshte 0.984 km²

Niveli i shfrytezimit eshte nga +810m deri ne +840 m mbi nivelin e detit.

HARTA TOPOGRAFIKE

I.-3 Topografia dhe klima e zonës

Teritori në të cilin shtrihet zona e objektit për të cilin kërkohet leja minerare e shfrytëzimit është një teritor kryesisht malor. Rajoni kap kuota nga 670 metra deri në 1000 metra mbi nivelin e detit.

Sheshi ku do të kryhen punime është kryesisht i çveshur nga bimesia. Krahas terrenit malor kemi edhe zona të buta, kryesisht në forme të kullotave alpine, sidomos në pjesën perëndimore, veriperëndimore e lindore të zonës.

Klima

Teritori në të cilin ndodhet zona e objektit, si në të gjithë pellgun e Bashkisë së Klosit dhe asaj të Bulqizës, përfaqësohet nga një klimë kontinentale, me dimër të gjatë e të ftohtë dhe verë të shkurtër e të nxehtë.

Periudha e dimrit shoqërohet me reshje të shiut dhe dëbores. Ngrica zakonisht fillon në fund të muajit Tetor dhe shpesh zgjat deri në fundin e muajit Mars.

Rreshjet e dëbores zakonisht e kalojnë trashësinë 1 metra. Muajt Janar dhe Shkurt

vlerësohen si muajt më të ftohtë të vitit, ku janë regjistruar temperatura deri -25 e -30° C.

Në këtë periudhë janë të shpeshta edhe bllokimet e rrugëve automobilistike nga ngrica dhe dëborë.

Periudha 15 Qershor - 30 Gusht, vlerësohet si periudha më e thate e vitit, me sasi të vogla shiu dhe shumë e nxehtë. Temperaturat maksimale të regjistruara në këtë

periudhë, sidomos gjatë vitit 2007 i kanë kaluar $+ 35^{\circ}$ C.

Zona është pothuajse gjithmone nën ndikimin e erërave që fryejnë në drejtime të ndryshme, sidomos veri lindje-jugperëndim dhe lindje-perëndim

Bimësia.

Në teritorin në të cilin ndodhet zona e objektit të mineralit të kromit, kemi të zhvilluar kryesisht pyje të përfaqësuara nga drurë pishë, bredhi, ahu etj. Përveç këtyre drurëve ndodhen edhe shkurre dhe bime karakteristike të zonës, sidomos në pjesën lindore dhe veriore të saj.

Hidrografia dhe Hidrologjia.

Rrjeti hidrografik është mjaft i zhvilluar dhe përfaqësohet nga numri i madh i

perrenjeve e proskave që ushqehen me ujë nga rreshjet e shumta atmosferike gjatë stinës së vjeshtës e pranverës.

Gjatë periudhës së dimrit perrenjte dhe proskat e zonës kanë sasira të ndryshme uji, kurse gjatë periudhës së verës janë pothuajse të thatë me përjashtim të disa burimeve të veçanta ujore të cilat kanë një sasi të vogël uji.

Demografia dhe infrastruktura ekzistuese.

Popullsia më e afërt e kësaj zone është ajo e qytetit të Bulqizës dhe fshatit Plani i Bardhe të Bashkisë së Klosit.

Popullsia e këtyre zonave është e punësuar kryesisht në sektorët e minierës së Bulqizës, Fabrikës së Pasurimit të kromit Bulqizë, etj. Fushe tjetër punësimi për banorët e zonës është emigracioni, ndërtimi, shfrytëzimi pyjor, përpunimi i lëndës drusore, tregtia, shërbimi komunal, arsimit, shëndetësia etj.

Zona e Bulqizës – Klosit, si gjithë zona veri-lindore e vendit, vlerësohet si një zonë e varfër dhe me nivel të ulët ekonomik.

Pozicioni gjeografik jo i favorshëm, largësia nga qendrat e mëdha urbane, infrastruktura rrugore e dobët, kushtet klimaterike të vështira etj, kanë çuar në një lëvizje të madhe të popullsisë drejt zonës qendrore Tirane-Durrës, ku mund të sigurohet një jetese më e mirë.

Premise e madhe për zhvillimin ekonomik të kësaj zone do të jete ndërtimi i rrugës së Arbrit, rruge e cila vazhdon të ndërtohet dhe do të afroje banorët e kësaj zone me Tiranën në një largësi rreth 50 - 60 km.

40%Cr₂O₃.

Te dhena te shkurtra për objektin

Zona për të cilën kërkohet leja e shfrytëzimit është përcaktuar sipas të dheëve të AKBN-se në planin vjetor të vitit 2018, si zona me nr.277/6, me anë të akteve nenligjore që kanë dalë në zbatim të ligjit nr.10304 datë 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”.

Objekti në fjale që kërkohet për leje minerare shfrytëzimi ben pjese në bashkinë Klos dhe është shfrytëzuar dhe me pare nga shoqeri te tjera.

A) Përshkrimi i qëllimit të projektit të propozuar

Në këtë raport teknik përfshihet objekti i përcaktuar sipas shkresës së Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë me njoftimin nr 11818/3 prot date 17.10.2018, të Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjisë me termt e meposhteme:

Prodhimi qe mendohet te realizohet ne zonen minerare 4000 ton/vit.

Sasia e prodhimit qe do te perpunohet 4 000 ton/vit

Vlera e investimit qe parashikohet per t'u kryer 10 000 000lek.

Vlera e rentabilitetit ekonomik (IRR) 13.6%

Hapja e karrierës

- Nxjerrja e mineralit te kromit
- Ngarkimi dhe transporti i mineralit deri ne fabrikat e pasurimit kromit dhe per eksport.
- Sistemimi i mbetjeve ne sheshin e depozitimit mbetjeve sipas projektit miratuar.

Te dhëna teknike te karrierës

Siperfaqja e karrieres 0.0416 km²

Gjatesia e karrieres 200-250 ml

Gjeresia e karrieres 125-150 ml

Thellesia e karrieres 40m

Numri i shkalleve te karrieres 4

Lartesia e shkalles ne karriere 10m.

Kendi i skarpates se shkalles 70-72⁰.

Gjeresia e shesheve te sigurise 2,5 - 3m

Ngarkimi dhe transporti te mekanizuar.

Rrezimi i mineralit me lende plasese.

Prodhimi ditor 22 ton/dit

Sheshi i depozitimit te mineralit me permasa 10x10m dhe sheshi i depozitimit sterileve 10x20m.

Kapaciteti prodhues vjetor 4 000 ton³

Fuqia punetore 7-8 veta

C) Informacion per qendrat e banuara

Ne afërsi te objektit nuk ka zona te banuara, qendra me e afërt e banuar është fshati Plani i Bardhe dhe qyteti i Bulqizës.

D) Pershkrim i proceseve ndertimore dhe teknologjike , kapaciteti prodhues .

- a. Vendosja e makinerive te prodhimit te mineralit te kromit, eskavatore, fadrome, kamiona etj.**

Gjate kryerjes se procesit te prodhimit te mineralit te kromit do te punojnë një brigade prej 8 vetash, ekskavatorist, shofer dhe tre punonjës etj. Materiali i prodhuar do te depozitohet ne sheshin e depozitimi mineralit. Ekskavatori do te ngarkoje mineralin ne automjete dhe te cilat do ta dërgoj ne fabrikat e pasurimit kromit dhe per eksport. Te gjitha këto makineri do te punojnë me nafte.

DH) informacion per infrastrukturën e nevojshme per lidhjet me rrjetin elektrik dhe furnizimin me uje

Ndërtimi i rrugësh hyrëse për ne objekt.

Është e ndertuar rruga deri ne karriere dhe do te behet riparimi nga vete shoqëria.

Ndërtimi i linjës elektrike.

Ne objekt nuk nevojitet energjia elektrike .

Rrezimi i mineralit

Rrezimi i mineralit do te behet me me dy mënyra

1. Me bira te zakonshme marteli
2. Me eskavator
3. Do te perdoret lende plasëse amonit.

Te dhënat teknike mbi thellësinë e birave, masën e ngareses me lende plasëse janë te përcaktuara me projekt.

Kapaciteti prodhues

Kapaciteti prodhues do te jete 4 000 ton/vit.

E) Programi per ndërtimin, kohëzgjatja e ndërtimit .

Hapja e karrierës do te behet për një afat 25 vjeçar, ne përputhje me kërkesat e Ligjit nr.10304 date 15.07.2010 “Për Sektorin Minerar ne Republikën e Shqipërisë”, me te drejte shtyrje per 10 vjet te tjera.

Të dhëna mbi identifikimin e ndikimeve në mjedis gjatë hapjes se punimeve minerare

Humbje e pjerresise se tokes

Ushtrimi i aktivitetit minerar ne kete zone do te shoqerohet me humbje te vogel pjerresise se tokes pasi karriera ka lartesi rreth 62ml.

Ndotja e tokes nga rrjedhjet

Aktiviteti minerar nuk do te shkaktoje ndotje te tokes nga rrjedhje pasi nuk do te kete rrjedhje ujrash ne siperfaqe te saj. Ujrat nentokesore do te vazhdojne te levizin ne te njejten rruge me ate qe kane rrjedhur deri tani.

Ndotja e tokes nga mbetjet e ngurta

Sasi e sterileve qe do te prodhohet nga karriera edo te depozitohen ne sheshin e sterileve, dhe do te depozitohet pothuajse teresisht ne sheshin e depozitimit mbetjeve qe do te jete nje siperfaqe e papaperfillshme.

Ndotja e tokes nga depozitimi i llumrave

Gjate shfrytezimit te objektit nuk parashikohet depozitime llumrash. Aktiviteti minerar ushtrohet ne karriere dhe mbetjet qe jane ne siperfaqe jane te ngurta e te patreteshme.

Erozioni gjate hapjes dhe shfrytezimit te objektit minerar.

Aktiviteti minerar ne kete objekt nuk do te shoqerohet me fenomene te erozionit. Ai prek nje siperfaqe te vogel dhe nuk e tjeterson ate .

Bimet e ujit

Ne zone ku do te ushtrohet aktiviteti i shfrytezimit nuk ka asnje lloj bime uji.

Flora dhe fauna

Ne zonen e shfrytezimit nuk ka ndonje lloj ose specie flore apo faune qe mabrohet me sataus te veçante. Flora dhe fauna lokale nuk do te preket nga shfrytezimi, mbasi siperfaqja e objekti eshte pothuajse e zhveshur nga bimesia.

Trajtimi i ujrave

Teknologjia shfrytezimit te objektit nuk parashikon perdorimin e ujit. Ujrat e reshjeve do te rrjedhin ne menyre natyrale.

Zhurmat gjate punes se hapjes

Burimi i kumuluar i zhurmave do te jene nga makinerite dhe pajisjet dhe jane brenda normave te Bashkimit Evropian.

Pluhurat gjate procesit te punes

Me qene se projekti nuk parashikon rrezimin e lende plasese ne projekt parashikohet perdorimi i mjeteve te thjeshta dhe eskavatorit sasi e pluhurit eshte minimale..

Ndikimi ne mjedis i produkteve te lendeve plasese

Nuk do te perdoret lende plasese.

Ndikim ne mjedis i gazeve te mjeteve motorike

Gjate fazes se zbatimit te projektit nuk do te kete emetime te gazrave, lengjeve, mbetje toksike, helme te ndryshme dhe substanca te tjera te demshme te cilat mund te ndikojne negativisht ne shendetin e punonjesve, banoreve dhe mjedisin per rreth duke perfshire te gjitha llojet e bimeve dhe gjallesave te ndryshme

Prodhimi i mbeturinave dhe depozitimi i materialeve qe krijohen gjate hapjes dhe shfrytezimit te objektit

Gjate hapjes dhe shfrytezimit te objektit do te kete vetem depozitim paraprak te nje sasie shume te vogel sterilesh te cilat do te sistemohen ne sipërfaqen e zones se shfrytezimit

Pastrimi rregullimi dhe rigjenerimi i pejsazhit

a) Planifikimi i zones;

Ne zonen e shfrytezimit hap pas hapi dhe ne perfundim te aktivitetit eshte parashikuar sistemimi, perpunimi shtrimi dhe ndertimi i nje sere muresh mbajtese ne stoqet e sterileve te trasheguara

Gjate ushtrimit te aktivitetit dhe kryesisht ne vitet e fundit te tij, parashikohet trajtimi i te gjithë sipërfaqes se shfrytezimit

b) Masat teknike,

Per parandalimin e erzoionit, shembjes dhe vithisjeve te ndryshme, ne zonen e shfrytezimit subjekti parshikon, cdo vit, te kryeje punime te ndryshme sistemi te sterileve te depozituara ne stoqet ekzistuese :

c) Masat estetike dhe ekologjike,

Gjate ushtrimit te aktiviteti te tij, subjekti i licensuar do te kryeje cdo vit sistemime

Dëmtime te sipërfaqes nga operacionet e germimit

Ne përfundim te shfrytezimit nuk do te kemi demtim te sipërfaqes pasi do te behet rehabilitimi i karrieres.

Ndikimi ne infrastrukturen e zones se objektit

Aktiviteti i transportit qe do te kryet nga subjekti i shfrytezimit nuk e rondon trafikun aktual, mbasi numuri i kamionave qe do te kalojne ne te eshte i vogel (maksimalisht 2-3 dite).

Ndikim ne shendetin e njerezveqepunojne ne objektidhe te banoreve per rreth.

Punonjesitqe do te jeneprezent ne objektgjateshfrytezimit te tij do te jene te mbrojtur nga mjetet personale mbrojtese kundra pluhurit dhe zhurmave te cilat do te jene te kufizuar vetem brenda zones se shfrytezimit.

Si rrjedhoje e projektit te zhvillimit te shfrytezimit ne kete objekt dhe ndikimeve pasuese mjedisore ne te, nuk do te kete dhe nuk priten ndikime ne shendetin e popullsise se zones dhe punonjesve te saj. Per pasoje nuk priten zhvendosje te tyre per shkak te ketij aktiviteti.

Ndikimi ne qarkullimindhetransportin

Aktiviteti i transporti qe do te kryet nga subjekti i shfrytezimit nuk e rondon trafikun aktual ne rrugen qe shkon ne zonat per rreth apo edhe ne rruget e tjera nacionale ne se do te duhet, mbasi numuri i kamionave qe do te kalojne ne te eshte i vogel.

Plani i monitorimit te mjedisit

a) Plani i monitorimit

Me qene se kemi te bejme me shfrytezimin me karriere te mineralit te kromit.

Plani i monitorimit do te konsistoje ne :

- Monitorimi i parametrave gjeometrike te stoqeve te sterileve ne afersi te karieres.
- Monitorimi i sjelljes se formacioneve ne kufijte e zones se shfrytezimi
- Monitorimi i i vazhdueshem i atmosferes ne objekt.

Shoqeria mer persiper sigurimin e ecurise normale te punes dhe ruajtjen e vazhdueshme te mjedisit deri ne mbylljen e aktivitetit, gjithashtu, do te kete lidhje te vazhdueshme me Agjensine Rajonale te Mjedisit, prane te ciles do te informoje periodikisht per mbarvajtjen e punes si gjate shfrytezimit ashtu dhe per minitorimin e parametrave te me mesiperm

Ê) lendet e para qe do perdoren per ndertimin e tyre.

Ky projekt do te shfrytezoje mineral kromi dhe per ndertimin e zyrave do te perdoren kontenier, uji do perdoret per uljen e pluhurave, dhe energjia do te perdoret me gjenerator.

F) informacion per lidhjet e mundeshme te projektit me projekte te tjera.

Po ne kete objekt do prodhohet mineral kromi i cili do dergohet ne fabrikat e pasurimit kromit dhe ne eksport.

G) informacion per alternativat e marra ne konsiderate.

Ne kete zone nuk ka dhe objekte te tjera per prodhimin e kromit ne afersi.

GJ) te dhena per perdorimin e lendeve te para gjate funksionimit

Ne kete objekt do te perdoret uji per te ulur pluhurat qe do te jete rreth 200 l /ne dite qe do te sillet me bot nje here ne jave dhe do te sigurohet ne fuqite e posaçme.

Lende djegese do perdoret nafta per automjetet qe do punojne ne objekt dhe do sigurohet ne nje depozite te sigurt per ruajtjen e saj ne objekt.

I) informacion per lejet autorizimet dhe licensat e nevojshme.

1 leje minerare shfrytezimi

2-leje mjedisore tipit B

J) Kopje te lejeve dhe autorizimeve qe disponon shoqeria.

Studio "Oskeola"shpk

